



REPUBLIKA E KOSOVËS
 KOMUNA E GJAKOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 OPŠTINA D JAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2024

Datë: 28.03.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 nr011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024 pas diskutimit lidhur me pikën e 12 të rendit të ditës: Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale-parkingu me numër të parcelës P-70708029-05831-1, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale Parkingu me numër të parcelës P-70708029-05831-1, me këtë përbërje:
 1. z. Nikollë Lleshi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
 2. z. Gani Hajdari, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
 3. z. Nik Hiseni, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
 4. znj. Krenare Bushaj, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
 5. znj. Erblina Dinarama, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar.
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtarëve të Komisionit Vlerësues .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .

